VENDIM
Nr. 45, datë 27.12.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK LEZHË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013 "Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të sh.a. UK Lezhë:

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizimi me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	58 lekë/m^3	18 lekë/m^3
Institucione buxhetore	135 lekë/m^3	22 lekë/m^3
Ente private	145 lekë/m^3	27 lekë/m^3

b) Tarifë fikse: 200 lekë/muaj/klient.

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2014:

- uji pa të ardhura (humbjet)	47 %
- niveli i matjes	75 %
- kohëzgjatja e furnizimit	20 orë/ditë
- eficienca e energjisë	2.5 kwh/m^3
- efikasiteti i stafit	6 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë	90 %
- mbulimi me kanalizime	90 %
- norma e arkëtimit	85 %
- cilësia e ujit (klor + koliform)	sipas standardeve.

3. Pagesa rregullatore vjetore për sh.a. UK Lezhë do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2014 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 1, datë 7.1.2013 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik", shfuqizohet.

KRYETARI
Avni Dervishi